



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI I SHKENCAVE TË APLIKUARA NË BIZNES
PEJË

Miratoi

Dekani
Prof, Dr. Armand Krasniqi

PROGRAMI I MODULIT – LËNDËS
“ORGANIZIMI I KONTABILITETIT”

Për Departamentin; Kontabilitet dhe Financë (KF) – viti i dytë

Viti shkollorë 2009 – 2010, Semestri i katërtë (IV) verorë

Përgjegjës i Departamentit

Prof. Ass. Dr. Adem Zogjani

Pejë, Dhjetor 2009



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI I SHKENCAVE TË APLIKUARA NË BIZNES
P E J Ë

Programi i Lëndës – Syllabusi

“ORGANIZIMI I KONTABILITETIT”

Departamenti / Kontabilitet dhe Financa në Biznes

Titulli i kursit (lëndës mësimore): ORGANIZIMI I KONTABILITETIT

Niveli dhe lloji i kursit: Bachelor/zgjedhore

Viti i studimeve dhe semestri: Viti i dytë, semestri verorë (KF) 2009/2010

Numri i orëve në javë: 3+2

Kodi ose shifra e lëndës:..... 2211

Vlera në kredi ECTS :..... 7

Koha/lokacioni: e ejte, ora10:20 – 12:40

Konsulenca: e ejte, ora 10:00 – 12:40

Mësimdhënësi i kursit: Prof. As. Dr. Adem Zogjani, 044 503 113

e-mail; ademzogjani@hotmail.com

Qellimi i Lendes

Ky kurs do t'u japë studentëve të vitit të dytë Departamenti Kontabilitet dhe Financë në biznes njohuri themelore mbi konceptet baze mbi orgaanizimit te kontabilitetit dhe strategjitë .Ai përcakton rolin e menaxherit në biznesin e ndërmarrjes, na njeh me rëndësinë e planifikimit dhe ndikimin e mjediseve makro dhe mikro ekonomike në vendosjen e objektivave të biznesit. Ne këtë kurs do të trajtohen çeshtje të tilla si planifikimi , organizimi, motivimi, dhe udheheqja e kontabilitetit,i të cilat do të thellohen më tepër në vitet ne vazhdim mbështetur në standardet ndërkombëtare te kontabilitetit. Një rëndësi e veçantë i kushtohet rolit të organizimit në shoqëri dhe në biznese qofshin këto fitimprurëse ose jo. Të gjitha njohuritë e mësipërme bazohen në arritjet më të fundit bashkëkohore në fushën e shkencave organizative dhe menaxheriale dhe përvojat shumëvjeçare të studimit të kontabilitetit dhe këtyre aspekteve në realitetin Kosovarë.

Për më tepër studentët në fund të këtij kursi do të kenë zhvilluar aftësitë e mëposhtme:

- Kuptimi logjik i koncepteve bazë mbi Organizimin e Kontabilitetit, dhe rolin e tij në raport me organizatën dhe shoqërinë në tërësi,
- Kuptimi i funksioneve te organizimit dhe lidhjes ndërmjet tyre,
- Aftësia për të asociuar konceptet teorike me situata të ndryshme në organizimin e kontabilitetit në praktikë,



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

FAKULTETI I SHKENCAVE TË APLIKUARA NË BIZNES

P E J Ë

- Konsolidimi i njohurive bazë, me qëllim zhvillimin e tyre të mëtejshëm në lëndë të tjera menaxheriale.
- Gjenerimin e një perspektive strategjike
- Organizimin e procesit të ndryshimit
- Krijimi dhe zhvillimi i grupeve në organizimin e Kontabilitetit
- Gjetjen e burimeve të informacionit dhe vleresimin e situatave reale
- Zhvillimin e mendimit kritik
- Përmiresimin e komunikimit dhe prezantimit verbal dhe të shkruar

Ngarkesa mësimore e lëndës për një grup leksion.

Lenda zhvillohet ne semestrin e katërtë (viti i dytë).

1 leksion = 60 minuta
Nr i javëve = 15
Totali i oreve leksione ne muaj = 4 jave X 3 ore = 12 ore
Totali leksione 15 jave X 3 ore = 45 ore leksion.

Ngarkesa për një grup seminari (ushtrime):

Nr i javëve = 15
Nr i orëve = 2 ore X 60 minuta
Ngarkesa mesatare mujore = 4 jave X 2 ore seminar = 8 ore
Ngarkesa totale = 15 jave X 2 ore = 30 ore

Zhvillimi i Seminareve dhe Raste studimore

Gjatë zhvillimit të ushtrimit dhe seminareve theksi vendoset në përsëritjen, kuptimin logjik, konsolidimin e njohurive teorike të marra në leksione (në formën e testeve 20 minutëshe) dhe mbi të gjitha zhvillimin e aftësisë për zbatimin praktik të tyre. Një pjesë të konsiderueshme të seminarit e zë puna me grupe të vogla studentësh (4 - 5 studentë), të cilëve iu jepen për diskutim raste të caktuara studimore nga realiteti i organizimit të kontabilitetit, në botë dhe në Kosovë. Në fund të orës së seminarit formulohen konkluzionet përmbledhëse, si dhe caktohen detyra për semnarin pasardhës.



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI I SHKENCAVE TË APLIKUARA NË BIZNES
P E J Ë

Detyrimet e lëndës

- Frekuentimi në leksione dhe seminare 10%
- Detyrë kursi seminari 1 (një) punim 10%
- Kolokviumi i parë 10%
- Kolokviumi i dytë 10%
- Provimi final 60%

Vlerësimi për studentin;

Prej	55 – 65 %	---	Nota 6
	65 – 75 %	---	Nota 7
	75 – 85 %	---	Nota 8
	85 – 95 %	---	Nota 9
	95 – 100 %	---	Nota 10

Pikët e vitit shtohen vetëm nëse studenti ka arritur të marrte të paktën 15% të provimit përfundimtar me shkrim .

Literatura bazë

1. Teoria e kontabilitetit, botimi i –V- SHBA; “Accounting Theory” –V- edicioni USA.
2. Principet e kontabilitetit, botimi i –IV-, SH.BA; “Accounting Principes” West Public Company” New York, USA
3. Schaun’s outline series, Theory and problems of cost Accounting” author, James A. Cachin & Ralph S. Polinen USA
4. Schaun’s outline series, Theory and problems of cost Accounting” author, James A. Cachin & Ralph S. Polinen USA, -II- editions



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI I SHKENCAVE TË APLIKUARA NË BIZNES
P E J Ë

S T R U K T U R A e L Ë N D Ë S

Java 1 (parë) :

1. Njohuri për organizimin e kontabilitetit

- 1.1. Biznesi bashkekohorë dhe kontabiliteti
- 1.2. Disa njohuri dhe përvoja në zhvillimin ekonomik dhe biznesit bashkekohore
- 1.3. Roli dhe rëndësia e kontabilitetit në zhvillimin e kompanisë dhe biznesit bashkekohore.
- 1.4. Funkcionimi dhe rregullimi juridik i sistemit të kontabilitetit në përputhje me parimet e ekonomisë së tregut

Java 2 (dytë):

1. **Modeli i kontabilitetit të menaxhimit të të ardhurave**
2. **Transaksionet e shitjes dhe blerjes**
3. **Elementet tjera të këtij moduli**

- 2.1. Evidentimi dhe përpunimi i faturave të shitjes, dhe “Libri i shitjes”
- 2.2. Evidenca e transaksioneve të pranimeve të gatëshme, libri i pagesave të gatëshme, (urdhër inkasimi, urdhër pagesa) “Ditari i arkës”
- 2.3.1. Transaksionet e huazuara duke i evidentuar dhe treguar në “Librin Kryesore”
- 2.3.2. Regjistrimet e të ardhurave të kësaj klientele si të ardhura të veçanta, në “Librin e të ardhurave” (Pasqyra e të ardhurave)
- 2.3.3. Raporti i përgjithshëm i prezantimit
 - 2.3.3.1.1. Kontabiliteti i të hyrave sipas llojit
 - 2.3.3.1.2. Pasqyra e klienteles
 - 2.3.3.1.3. Analiza e të hyrave
 - 2.3.3.1.4. Shitja e produkteve



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI I SHKENCAVE TË APLIKUARA NË BIZNES
P E J Ë

Java 3 (tretë):

1. Rendesia e organizimit te kontabilitetit ne biznes

3.1. Hartimi dhe komentimi i skemes organizative te nje kompanie

- 3.1.1. Organizimi i kontabilitetit ne kuader te sistemit te organizimit te ndermarrjes – kompanise
- 3.1.2. Lidhshmerite dhe ngjashmerite ne mes te departamenteve te kontabilitetit dhe financave, me departamente tjera te organizimit te ndermarrjes – kompanise
- 3.1.3. Ndikimi i organizimit te departamentit te kontabilitetit ne rendesin e faktoreve te ndermarrjes (zvogelimi i shpenzimeve, rritjen e te ardhurave, ne percaktimin e mjeteve investuese etj)

Java 4 (katërtë):

1. Faktoret e ndikimit ne organizimin e kontabilitetit

- a) Faktoret e jashtem; tregu, institucionet, okupimi
- 4.1. kultura shoqerore dhe pjeset ekultures se kontabilitetit
 - Elemente e kultures shoqerore
 - ◆ Institucionet (politika dhe ekonomia, taksat dhe tatimet, finacimi i korporatave), dhe profesionalizimi i kontabilitetit
 - ◆ Lidhshmerit e ketyre faketoreve te shprehur neper mes te rregullimit te kontabilitetit e cila bene pjese ne sistemin e kontabilitetit qofte ne menyre vullnetare apo kerkese praktike
 - ◆ Kontabiliteti si lidhshmeri eshte edhe pjese e kultures shoqerore
- b) **Ndikimi ekologjik vendore duke perfshire faktorin demografike dhe gjeografik qe ndikojne ne sistemin e kontabilitetit**

Java .5. (pestë):

1. Kolokviumi parë

- 5.1. Test kontrolli në grupe, zgjatë 20 – 30 minuta
- 5.2. Debate të përbashkëta për test kontrollin 45 minuta
- 5.3. Kolokfium i -I- parë, zgjatë 30 – 45 minuta.



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI I SHKENCAVE TË APLIKUARA NË BIZNES
P E J Ë

Java 6 (gjashtë):

1. Konkurencat ekonomike shoqerore ne politiken dhe organizimin e kontabilitetit

- 6.1. Rregullimi ligjore i kotabilitetit
 - pro dhe kontra

- 6.2. Politika menaxheriale e kontabilitetit
Rrethina e organizimit te kontabilitetit
 - o ekonomia privte
 - o tregu i kapitalit
 - o vlera e aktivave (aseteve, mjeteve te angazhuara)
 - o konkluzionet

.Java 7 (shtatë):

1. Politika menaxheriale ne organizimin e kontabilitetet

- 7.1. Qeveria dhe partneret (bizneset dhe qytetaret)
- 7.2. Roli i standardeve te kontabilitetit
- 7.3. Vleresimi perfundimtare
- 7.4. Rezyme – permbledhje

Java e 8 (tetë):

1. Problemet e organizimit te kontabilitetit

- 8.1. Centralizimi dhe decentralizimi i organizimit dhe menaxhimit te kontabilitetit
- 8.2. Formimi dhe aplikimi i modelit te organizimit te ekonomise dhe kompanise
- 8.3. Struktura organizative e menaxhimit te kompanise nga spekti funksional
- 8.4. Modeli i organizimit te kompanis nga spekti prodhues
- 8.5. Modeli i organizimit te kompanis nga aspekti gjeografik
- 8.6. Modeli i organizimit te kompanise sipas niveleve te menaxhimit te kompanise
- 8.7. Prezanitimi i nje apo disa kompanive konkrete te organizimit te teresishem sipas departamenteve dhe organizimit te kontabilitetit

Java e 9 (nëntë):



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

FAKULTETI I SHKENCAVE TË APLIKUARA NË BIZNES

P E J Ë

1. Roli i organizimit te kontabilitetit te kosos ne biznes.

- 9.1. Karakteristikat dhe struktura e organizimit bashkekohore dhe te ndermarrjes ne kuader te sistemit te skemes organizative ne ndermarrje.
- 9.2. Raportet e lidheshmerise se njesive (departamenteve), ne funksionimin e sistemit menaxhues te kompanise (organet e qeverisjes ne per mjet akcionareve, bordit te drejtoreve, kryetarit dhe sekretarit te kompanise)
- 9.3. Prezantimi i aktiviteteve menaxhuese dhe organizative te stafit te departamenteve, (marketingu, resurseve njerezore te prodhimit, inxhinjeringut dhe financave)

Java e 10 (dhjetë):

1. Modeli i Organizimit te kompanizve sipas niveleve

- 10.1. Skema organizimit te kompanise sipas tri modeleve
 - 10.1.1. Niveli i pare, Nenkryetaret dhe presidentet e kompanise
 - 10.1.2. Niveli i dyte ne departamentin e prodhimit jane keshilletaret varesishte nga aktivitetet, gjegjesishte lemite qe kryhen ne kuader te ketij departamenti prodhues
 - 10.1.3. Niveli i trete, departamenti i sherbimeve sipas sektoreve te ndryshem dhe sherbimeve perbehet nga menaxheret

Java e 11 (njëmbdhjetë):

1. Modeli bashkekohore i organizimit te kontabilitetit.

- 11.1. Karakteristikat dhe struktura e organizimit te kontabilitetit
- 11.2. Niveli i pare, organizimi vertikal i kontabilitetit perbehet nga presidenti i kompanise per financa ne menaxhimin e departamentit per Financa dhe kontabilitet
- 11.3. Niveli i dyte, Asistentet kontrollor, (rendesia e kontrollit), te menaxhimit te kontabilitetit
- 11.4. Niveli i trete i menaxhimi, skema e organizimit te kontabilitetit dhe struktura e saje;
 - Menaxheri i kosos
 - Menaxheri i tatimeve
 - Menaxheri i buxhettit
 - Menaxheri i pergjitheshem i kontabilitetit
 - Menaxheri i auditimit dhe
 - Menaxheri i sistemit te organizimit te kontrollit
- 11.5. Pershkrimi i aktiviteteve te cdo lloj niveli te organizimit

Java e 12 (dymbndhjetë):



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

FAKULTETI I SHKENCAVE TË APLIKUARA NË BIZNES

P E J Ë

1. Seminar

Test në përsëritjen, kuptimin logjik, (në formën e testeve 20 minutëshe) mbi të gjitha zë puna me grupe të vogla studentësh (4 - 5 studentë), të cilëve iu jepen për diskutim raste të caktuara studimore nga realiteti i organizimit të kontabilitetit, në botë dhe në Kosovë. Në fund të orës së seminarit formulohen konkluzionet përmbledhëse, si dhe caktohen detyra për seminarin pasardhës (detyrë shtëpie)

Java e 13 (trmbdhjetë):

1. Kolokfiumi i dytë

- 13.1. Test kontrolli në grupe, zgjatë 20 – 30 minuta
- 13.2. Debate të përbashkëta për test kontrollin 45 minuta
- 13.3. Kolokfiumi i -II- dytë, zgjatë 30 – 45 minuta

Java e 14 (katërmbdhjetë):

1. Sistemi i organizimit të kontabilitetit për vendete anetare të BE-s, për fondet e Bashkimit evropian

- 14.1. Respektimi i marreveshjeve për ndarjen e fondeve të BE-s
- 14.2. Raportimet e shteteve anetare të BE-s, Keshillit të Evropës
- 14.3. Pasojat e shteteve anetare të BE-s, nga raportimet jo të saketa
- 14.4. Rezume - përmbledhje

Java e 15 (pembëdhjetë):

1. Mbyllja e llogarive

- 15.1. Veprimet kontabile të mbylljes së llogarive
- 15.2. Pasqyrat vjetore financiare dhe harmonizimi i tyre me Raportimet tremujorese, në pajtueshmëri me ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës

Literatura shtesë

- 1. Kontabiliteti III dhe IV nga Prof Dr. Agim Binaj dhe Prof Dr. Flutra Kalemi
- 2. Ligjeratat e shkruara varesisht nga tematika dhe përmbajtja e ligjeratave nga profesorori i cili jep lekcionet “Organizimi i kontabilitetit”